



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:000047

Datë: 18.07.2022

Numri i dokumentit: 03236844

PKR.nr.7/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues Shaqir Zika, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë e kësaj gjykate, në lëndën penale ndaj të akuzuarit E. H. nga Rahoveci, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 prg.2 lidhur me prg.1, nënprg.1.4 të KPRK-së. dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuari L. L. nga Rahoveci, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nënprg.1.4 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë- Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP/L.nr.272/2021 të datës: 24.01.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 05.07.2022, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, si dhe të akuzuarve, me datën 06.07.1011 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa **me datën 18.07.2022** përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.E. H., nga i ati Sh. dhe nëna G. e gjinisë D., data e lindjes . . . në Rahovec, ku edhe banon në rr. . .”, i martuar, me nr. personal. . . , me profesion punëtorë fizik, shqiptar, shtetas i Republikës të Kosovës.

2.L. L., nga i ati J. dhe nëna Sh. e gjinisë A., data e lindjes. . . në Rahovec, ku edhe banon në rr. . .”, pn, i pa martuar, me nr. personal. . . , ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës të Kosovës.

J A N Ë F A J T O R

I pandehuri E. H.

I.Me datë 15.12.2021 në Rahovec, në rr. “. . .”, tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë ditën kritike rreth orës 12:00/h, pasi kishte shkuar i dëmtuari L. L. tek shtëpia e mikut-babait të gruas së të pandehurit E. H., me qëllim për ta njoftuar se miku i tij E.i po i kërkon substanca narkotike - marihuanë dhe që të ndalohet pasi

që vetë nuk është përdorues, takohen mes vete dhe se në fjalosje e sipër i pandehuri e nxjerr sprejin me gas dhe ja hedhë në fytyrë, duke i shkaktuar në këtë mënyrë lëndime të lehta trupore të përshkruara me ndrydhje të indeve të buta të regjionit ballor të kokës me konjunktivit traumatik, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, si në Ekspertizën mjeko-ligjore të Dr.F. B.të dt.21.01.2022.

-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 prg.2 lidhur me prg.1, nënprg.1.4 të KPRK-së.

II. Më parë ka siguruar e gjerë me dt.15.12.2021 ka mbajt në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar armë në kundërshtim me Ligjin nr 05/L-022 për Armët, për çka pas një fjalosje të çastit në mes të pandehurit në një rën anë dhe të dëmtuarit L. L. në anën tjetër, i pandehuri nxjerr sprejin e gasit nga xhepi dhe ja hedhë në fytyrë të dëmtuarit për çka me të njoftuar policia të njëjtën i'a sekuestron.

-me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës nga neni 366 prg.1 të KPRK-së.

I pandehuri L. L.

III. Me datë 15.12.2021 në Rahovec, në Lagjen e Epërme, në rr. “. . .”, tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë ditën kritike rreth orës 12:00/h, pasi kishte shkuar në shtëpinë e mikut të të dëmtuarit E. dhe me tu takuar me të në mosmarrëveshje e sipër mes vete e sulmon duke e kapur për fyti, duke i shkaktuar kështu lëndime të lehta trupore të përshkruara me ndrydhje të indeve të buta të fytyrës dhe anës së djathtë të qafës, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, si në Ekspertizën mjeko-ligjore të Dr.F. B.të dt.21.01.2022.

-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 prg.1 nënprg.1.4 të KPRK-së.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 6, 7, 17 par 1, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 59, 69, 70, dhe nenit 185 prg.2 lidhur me prg.1, nënprg.1.4, 366 par.1 të KPRK-se, dhe neneve 359 par. 2, 367, 450 të KPPK-se të akuzuarit i

G J Y K O N:

1. Të akuzuarin E. H., për veprën penale nga dispozitivi I të akuzës, për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 prg.1 nënprg.1.4 të KPRK-së, i shqipton DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Për dispozitivin II të akuzës, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i shqipton DËNIM ME

BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit te verifikimit prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale,

Në bazë të nenit 76, të KPRK-së, i shqipton

DËNIM UNIK ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë(10) muajve, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej një(1) vite e gjashtë (6) muaj, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale,

2.Të akuzuarin L.L., për dispozitivin III te akuzës, për vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 prg.1 nënprg.1.4 të KPRK-së , **ME DËNIM ME KUSHT,** duke ia vërtetuar dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit te verifikimit prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Të akuzuarit E. H., konfiskohet: spreji i gasit , si objekt i veprës penale.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ky Sprej i gasit duhet të shkatrohet nga policia e Kosovës.

Detyrohet të akuzuari, që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë me nga tridhjetë (30) Euro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë me nga pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokurorisë Themelore në Gjakovë- Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë PP/I.nr.272/2021 të datës: 24.01.2022, kundër të akuzuarit E. H. nga Rahoveci, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 prg.2 lidhur me prg.1, nënprg.1.4 të KPRK-së. dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe i akuzuari L. L. nga Rahoveci, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nënprg.1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 05.07.2022, në të cilin kanë marr pjesë Prokurori i shtetit Ramiz buzhalala si dhe të akuzuarit E. H. dhe L. L..

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhalala, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarve, andaj ka propozuar që të njëjtit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

I akuzuari E. H. deklaron se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilën akuzohet dhe shton se i vijën keq për rastin, premtion se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale, me këtu të dëmtuarin- të pandehurin L. pas rastit raportet i kemi rregulluar, dhe i propozoi gjykatës që të më shqiptoi një dënim sa më të butë të paraparë me ligj.

I akuzuari L. L. deklaroi se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilën akuzohet dhe shton se i vijën keq për rastin, premtori se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale, me këtu të pandehur E. pas rastit raportet i kemi rregulluar, dhe i propozoi gjykatës që të më shqiptoi një dënim sa më të butë të paraparë me ligj.

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala deklaroi se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë të bërë nga të akuzuarit, pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës , pranimi i fajësisë u bë i vullnetshëm, pa presion duke ditur edhe pasojat e pranimi të fajësisë, gjykatës i propozoi që të bëjë pranimin e fajësisë. Me rastin e vendosjes lidhur me dënimin të merr parasysh krahas rrethanave rënduese edhe pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese.

Pasi që këtu të akuzuarit pranimin e fajësisë e kanë bërë në mënyrë të vullnetshme, pas shpjegimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e propozuara nga prokurori i shtetit dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje që qartë ligjore apo gabim faktik,

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve për veprat penale për të cilat janë ngarkuar me aktakuzë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimi të fajësisë kryetari i trupit gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit pas shpjegimeve të mjaftueshme nga gjykata, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë kryetari i trupit gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se të akuzuarit E. H. me dashje ka kryer veprat penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 prg.2 lidhur me prg.1, nënprg.1.4 të KPRK-së, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe i akuzuari L. L., me dashje ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 prg.2 lidhur me prg.1, nënprg.1.4 të KPRK-së. në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në dispozitivin I,II,III të këtij Aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, kryetari i trupit gjykues të akuzuarit E. H. e ka shpall fajtor për veprat penale ngase në veprimet e tija të përshkruara si në dispozitiv I,II të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale: lëndim i lehtë trupor nga neni 185 prg.2 lidhur me prg.1, nënprg.1.4 të KPRK-së, dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe të akuzuarit L. L., e ka shpall fajtor për veprat penale ngase në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitivin III të Aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale: lëndim i lehtë trupor nga neni 185 prg.2 lidhur me prg.1, nënprg.1.4 të KPRK-së. për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit Gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve: në gjykim kanë pasur qëndrim tejet korrekt, pendimin e tyre, moshën e tyre të re, të njëjtit pas rastit janë pajtuar, nuk i janë bashkangjitur ndjekjes penale, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestarë, si dhe faktin se më parë nuk kanë qenë të dënuar për ndonjë veprë tjetër penale si dhe gjendjen e tyre ekonomike, Andaj ndaj të njëjtëve ka shqiptuar dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me të cilat dënime do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së dhe se këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat e kryera penale dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 366 paragrafi 3 të KPRK, kryetari i trupit gjykues ka vendosur që ndaj të akuzuarit të konfiskohet gazi i sprejit, si objekt i veprës penale.

Duke e pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenet 451 paragrafi 1 dhe 453 të KPP-së si dhe konform nenit 39 paragrafi.3 nënparagrafi.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, kryetari trupi gjykues ka vendosur që i akuzuari t'i paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti për Krime të Rënda -
PKR.nr.7/22, të datës 18.07.2022

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Kryetari i trupit gjykues,
Shaqir Zika

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.